



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbështetje të nenit 104 dhe 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 të Ligjit Nr. Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, dhe nenit 9 të Rregullores nr. 05/2016 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve dhe Marrëveshjes për Drejtësi te arritura ne Bruksel, më datën 10 shkurt 2015, e cila është vazhdimësi e Marrëveshjes së Parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin Nr.04/L-199- GZ,nr.38, 17 shtator 2013, shpall

KONKURS PUBLIK

**PËR REKRUTIMIN E TRIDHEJET (30) POZITA E GJYQTARËVE NE NIVEL TË GJYKATAVE
THEMELORE DHE SHTATE (7) POZITA E GJYQTAREVE NGA KOMUNITETI JO SHUMICE**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E GJYQTARËVE

Detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve përfshijnë:

- ushtrimin e funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe kodin e etikës profesionale;
- të ndërmarrë të gjitha veprimet siç specifikohen me ligj.

KRITERET DHE KUALIFIKIMET

I. Kandidatët për t'u emëruar gjyqtar, siç parashihet në nenin 104 dhe nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet plotësuar kushtet e përgjithshme si në vijim:

- I.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- I.2. të ketë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshëm në Kosovë;
- I.3. të ketë të kryer provimin e Jurisprudencës të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë;
- I.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
- I.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale;
- I.6. të ketë së paku tre (3) vite përvojë në fushën juridike, dhe

I.7. të ketë kaluar provimin për gjyqtar, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.

Siç specifikohet në Ligjin për Gjykatat, përvoja në fushën juridike nën 26 (pika 1.6) përfshin përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

FORMULARI I APLIKACIONIT

Formulari është i gatshëm në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga ku mund të shkarkohet www.gjyqesori-rks.org

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Afati i dorëzimit të aplikacioneve fillon prej 31 janar 2018 deri më 02 mars 2018 ora 16:00. Aplikacionet e plotësuar duhet të dërgohen në zyrën e pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në adresën:

Rruga Luan Haradinaj Nr. 133

Prishtinë, 10000

Republika e Kosovës

Aplikacionet duhet dorëzuar brenda afatit të caktuar. Aplikacionet e dorëzuara pas skadimit të këtij afati nuk do të pranohen.

DOKUMENTET E OBLIGUESHME QË DUHET TË DORËZOHEN SIPAS RREGULLORES PËR REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E GJYQTARËVE

Luteni që të dorëzoni vetëm kopjen e vërtetuar/noterizuar të dokumenteve të listuara më poshtë. Dokumentet origjinale nëse kërkohen duhet t'i dorëzoni gjatë fazës së intervistës.

Kandidatët në pajtim me Rregullore për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e Gjyqtarëve, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Formën Standarde të Aplikacionit (gjejeni në: www.gjyqesori-rks.org)
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Kosovë;
- Certifikatën e vlefshme mbi dhënien e provimit të jurisprudencës;
- Certifikatën që vërteton se kandidati nuk është i dënues për vepra penale, siç është caktuar me ligjet në fuqi;
- Dëshminë mbi përvojën e punës siç është përcaktuar me ligj.

NJOFTIMI PARALAJMËRUES

Sipas nenit 9 të Rregullores 05/2016 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e shpallura për pozitën për të cilën aplikojnë, dhe aplikacioni i tyre duhet të dorëzohet jo më vonë se data e përcaktuar në Konkurs Publik.

Dokumente Shtesë Sipas nenit 9 të Rregullores nr. 05/2016 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, kandidatët duhet të dorëzojnë informatat e siguruar nga punëdhënësi për tre (3) vitet e fundit të përvojës profesionale të cilat përfshijnë përshkrimin e detyrave të punës, performancën profesionale, masat eventuale disiplinore dhe çështje tjera që konsiderohen relevante, të

shoqëruara me dokumente mbështetëse, për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale siç parashihen edhe me nenin 17 të Ligjit për KGJK-në.

VEPRIMTARIA PROFESIONALE/AKADEMIKE

Kandidati po ashtu duhet të dorëzojë, nëse e ka në dispozicion, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokumente ligjore profesionale apo akademike apo publikime, të kryera krejtësisht nga kandidati (maksimumi tri);
- Informacion për pjesëmarrje në forma të organizuara të trajnimit në të cilën është vlerësuar performanca (maksimumi tri).

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATË

Këshilli Gjyqësor i Kosovës informon të gjithë kandidatët që do të bëhet verifikimi i dokumenteve dhe deklaratave të dorëzuara për të mbështetur aplikimin. Po ashtu kandidatët të cilët nuk i kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara brenda afatit, aplikacioni i tyre do të refuzohet.

Neni 35 paragrafi 3 i Rregullores 05/2016 parasheh se kandidatët të cilët e kanë përfunduar provimin dhe trajnimin fillestar të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës do ti nënshtrohen vetëm intervistës me gojë, procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve, siç është e përcaktuar edhe me nenin 23 të kësaj Rregulloreje.